

FATOS KONGOLI
NJË ËNDËRR EUROPIANE
MES AL PAÇINOS DHE KAVABATËS
PROZË

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

NJË ËNDËRR EUROPIANE
MES AL PAÇINOS DHE KAVABATËS

prozë

ribotim

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Yllka Avxhi
Përkujdesja grafike: Edona Marku
Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-277-76-3

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Po të pranojmë se titulli shpreh idenë e një shkrimi, më duhet të pohoj nga ana ime se në prag të udhëtimit european Jug-Veri nuk kisha kurrfarë ideje në kokë, aq më pak diçka që të lidhej me Al Paçinon dhe Kavabatën. Nuk dija edhe diçka tjetër: në rastin tim udhëtimi nuk do të ishte thjesht një zhvendosje në hapësirë. Shumë shpejt ai do të kthehej në një zhvendosje në kohë, në drejtimin e kundërt të rrjedhës. Dhe është absurde gjendja kur mendon se fluturon drejt së ardhmes ndërsa, në të vërtetë, ndihesh i mbërthyer nga e kaluara. E kuptoj, është e trishtueshme kjo, madje e rrezikshme, por njeriu e ka të vështirë t'i shpëtojë vetvetes. Prandaj lutem të më lejohen tri paranteza. Ato mund të jenë fare të kota dhe nuk do të më vinte keq nëse kalohen pa u lexuar. Tek e fundit janë një varg paradoksesh.

Dy vjet të shkuara, pjesëmarrjen time në Trenin e Letërsisë 2000 e mësova në rrethana disi surrealistë. Për herë të parë më kishte ardhur një ftesë nga ambasada e Iranit dhe unë ngurrova të shkoja për një arsye banale: kisha shkullur pothuaj të gjithë dhëmbët. Më mbeteshin katër copë të fundit, sipër, por gjithsesi, derisa t'i shkulja edhe ata, më shërbenin si vitrinë, dukeshin me dhëmbë, mjafton të mos qeshja. Një miku im diplomat më uron. Unë mezi e kuptova përse më uronte. Gazetat e kryeqytetit njoftonin pjesëmarrjen e një tresheje shkrimtarësh shqiptarë në një udhëtim fantastik me tren. Gazetat nuk i lexoja prej kohësh dhe u zura në befasi. M'u duk diçka e pabesueshme. Dhe me vete mëmërita: o Zot, përse kaq vonë?

Pas një viti u njoftova se isha ftuar në Paris me rastin e përrurimit zyrtar të veprimtarisë dhe këtu është vend i parantezës së parë. Ajo nuk ka lidhje me Parisin, as me aventurën europiane të Trenit. Përmban diçka vetjake dhe mund të gjykohet pa vend po aq sa shkulja e dhëmbëve dhe zëvendësimi i tyre me proteza që, gjithsesi, e korrigjuan në mënyrë të ndjeshme pamjen time, sidomos kur qeshja e zbuloja ca dhëmbë të degraduar, dhe të gjithë e dinë se unë nuk mund të rri pa qeshur edhe kur, në të vërtetë, më vjen për të qarë.

Kështu edhe ato ditë në Paris, më vinte për të qarë. Idiotësisht. Vajza ime sapo qe larguar si emigrante ekonomike për në Shtetet e Bashkuara, në Nju-Jork, e mua më dukej se dikush kishte futur dorën brenda meje, më kishte shqitur mushkëritë e nëse dhëmbët e degraduar në errësirën e dekadave i zëvendësova me proteza, largimin bashkëkohor të vajzës nuk mund ta zëvendësoja me asgjë, e vuaja idiotësisht: të gjithë më thoshin se duhej të isha i lumtur, vajzës sime i kishte buzëqeshur fati, ajo po i shpëtonte mizerabilitetit pa fund të

Shqipërisë, mund të quhej e zgjedhur nga Zoti. E kuptoja këtë, më saktë përpiqesha ta kuptoja. Dhe nuk e dija se pas vajzës i njëjti fat do t'i buzëqeshte tim biri, raft tepër i rrallë ky, edhe atë Zoti e ndihmoi të largohej nga Shqipëria, të nisej edhe ai për në Shtetet e Bashkuara si emigrant ekonomik, e kjo ndodhi pikërisht një javë përpara se unë t'i hipja avionit për në Zyrih e nga Zyrihu në Lisbonë. I përfshirë nga një përhumbe, nuk e mblidhja dot veten. Ky shpërqendrim më bëri t'i futesha aventurës së Trenit i papërgatitur. Si një gjethe e këputur, të cilën rrjedha e lumit e merr dhe e çon ku të dojë. Mua më çoi drejt Al Paçinos dhe Kavabatës.

Edhe diçka për ta mbyllur këtë parantezë të parë. Gjendjen time të çbaraspeshuar e vulosi një rrethanë ndaj së cilës u tregova i pafuqishëm: mosnjohja e gjuhës angleze. Bezia e të ndierit shpesh jashtë loje për shkak të këtij defekti të formimit tim të dikurshëm, tashmë vështirë të korrigjueshëm, nisi për mua që në Lisbonë, në pritjen zyrtare kur u përkthye vetëm në anglisht, gjermanisht e rusisht, dhe vazhdoi deri në fund në Berlin.

Në këtë pikë më duhet të hap parantezën e dytë. Edhe kjo nuk lidhet me Trenin. Është përsëri diçka vetjake dhe mund të tingëllojë po aq pa vend sa episodi i shkulljes së dhëmbëve, emigrimi i dy fëmijëve dhe gjendjet e mia të shpeshta nervoze për shkak të mosnjohjes së gjuhës së Shekspirit. Nuk mund ta shpjegoj përse pas pritjes në Lisbonë, kur u kthyem në hotel dhe u mbylla në dhomë, si kisha dëgjuar tërë kohën përkthimet në rusisht për të kuptuar ndonjë gjë, zura të recitoja befas në gjuhën ruse. Qe diçka e habitshme. Recitova Lermontovin, një poezi të Pushkinit, strofa të harruara nga fabulat e Krillovit dhe u përfshiva nga një gjendje gati e sëmurë. Gjuha ruse tek unë qe varrosur prej kohësh, disa dekada më parë. Unë nuk do ta besoja se pas kaq dekadash brenda meje do të kishte mbetur diçka, e kjo diçka të pluskonte nga thellësitë e të dilte në sipërfaqe këtu, në Lisbonë. Dhe, tek vështroja i hutuar qiellin sensual të Lisbonës, mendova se, në fund të fundit, ajo që po ndodhte me mua nuk ishte dhe aq e papritur. Qytetërimi rus ka qenë ndër burimet e para të formimit tim, që

m'u imponua nga kujdestarët e adoleshencës dhe rinisë sime. Ishte epoka e lulëzimit të miqësisë e të ashtuquajturit Kamp Socialist Lindor në antagonizëm me Kampin Kapitalist Perëndimor. Në njërën anë NATO-ja, në tjetrën Traktati i Varshavës, në mes Muri i Berlinit. Dhe unë, prodhim i epokës, me vulën e pashlyeshme të saj.

Kjo epokë mbyllet me paradoksin ndoshta më të çuditshëm të jetës sime. Ai lidhet me atë që po e quaj ndërgjegjësim timin europian e ky ndërgjegjësim ndodhi në Kinë. Në një kohë kur lexoja rusisht Çehovin dhe më dukej e natyrshme t'i vazhdoja më tej studimet në Moskë, kujdestarët e mi ndërruan drejtim, për mua u zgjodh Pekini. Bashkë me Pekinin, shkenca më e magjishme, matematika. Kjo përkon me zbulimin tim të parë asgjësues: nuk kisha talent për matematikë. Ishte fillimi i viteve '60. Mbi ndikimet e qytetërimit rus me ngjyrimet e theksuara sovjetike, brenda meje zunë të shtresoheshin elementet e qytetërimit kinez. Gjuha, mënyra e jetesës, një botë po aq e pakuptueshme në pamje sa simbolet e

Operës së Pekinit, më mbështollën në rrjetën e një pështjellimi të plotë. Qytetërimi kinez paraqitej i mbyllur: një Mur i Madh më ndante prej tij, hieroglifët. Mirëpo, me gjithë pengesën e hieroglifëve, qytetërimi kinez u shfaq për mua i prekshëm. Vërtet nuk isha në gjendje të studioja Konfucin, doktrinën taoiste apo budizmin, por mund të bëja dashuri me vajza kineze! Asgjë nuk ta afron më shumë një qytetërim, nuk ta shfaq më të kuptueshme një botë të panjohur, sesa femra. E zbulova këtë në Kinë, ku një europian, e atje unë isha një europian si gjithë të tjerët, për një mijë arsye që nuk ia vlen të zgjatemi këtu, nuk e kishte të lehtë të bënte dashuri me vajza kineze. Dhe kështu, si u ndërgjegjësova së pari në Kinë lidhur me përkatësinë time europiane, mbërrij në parantezën e tretë, me dy paradokse të fundit.

Atë mbrëmje në Lisbonë, në prag të udhëtimit, duke soditur qiellin turbullues të Portugalisë, arrita të formuloja në tru diçka që e dija prej kohësh, por që atë natë m'u duk si

zbulim: kisha mbetur një produkt i parealizuar i epokës. Dikur, për arsye të prishjes politike dhe ideologjike me sovjetikët, ecuria e jetës sime u ndërpre, mori një drejtim tjetër. Më pas, për arsye të një prishjeje të re politike dhe ideologjike, kësaj radhe me kinezët, ecuria e jetës sime u ndërpre përsëri, u ktheva në atdhe pa i mbaruar studimet, pa përfunduar asgjë, me dy gjuhë të huaja që nuk më hynin në punë, i bindur përfundimisht se matematika nuk ishte për mua. Kjo përkon me vetizolimën e plotë të Shqipërisë, kthimin në geto të një vendi të vogël, të harruar nga bota, të braktisur në fatin e vet, në një cep të Ballkanit. Europa ndodhej aty, fare pranë, por për paradoks, ajo ishte një galaktikë e largët, e paarritshme. Tashmë gjendesha brenda një tuneli të errët, lëvizja pa ditur ku shkoja, pa asnjë xixëllimë drite. Në këto kushte e vetmja hapësirë lirie ku arratisesha në vetmi u bë gjuha e Molierit. Në shkollën e mesme, përveç ruseshtes që ishte e detyrueshme, ne mund të zgjidhnim si gjuhë të huaj të dytë fakultative një nga tri gjuhët e mëdha perëndimore: anglisht, gjermanisht

ose frëngjisht. Sipas këshillës së tim ati, unë zgjodha frëngjishten. I jam mirënjohës për këshillën dhe, me këtë rast, lutem që shpirti i tij (ishte artist, kishte studiuar violinë për shtatë vjet në Konservatorin e Paviors, në Itali) të prehet i qetë atje ku ndodhet. Me tim atë lidhet edhe paradoksi i fundit.

Kur e pyeta një herë në muzgun e jetës së tij përse që bërë komunist, ai nuk dredhoi, m'u përgjigj se gjatë viteve në Itali kjo kishte qenë zgjedhja më e mirë. "Para meje, - më tha, - shtroheshin dy alternativa, të përqafoja komunizmin e Antonio Gramshit ose fashizmin e Duçes..." Nuk dua ta gjykoj tim atë, por sigurisht, përveç fashizmit të Duçes dhe komunizmit të Gramshit, në atdheun e Verdit ekzistonin edhe alternativa të tjera. Në muzgun e jetës, kur përfundoi në mënyrë tragjike, i dënuar e i flakur si limon i shtrydhur nga partia e vet, ai e kalonte kohën duke luajtur në piano fuga të Bahut, derisa vdiq i braktisur edhe nga miqtë më të ngushtë. Kjo ndodhi kur unë, si e kisha lënë, më në fund, matematikën për t'u marrë me letërsi, kuptova se kisha bërë

gabimin ndoshta më të rrezikshëm të jetës. Falë gjuhës së Molierit, m'u krijua mundësia të bija në kontakt me autorët e mëdhenj të shekullit XX dhe fillova pak a shumë të marr vesh ç'është letërsia e vërtetë. Dhe të bëja letërsi të vërtetë në një vend si Shqipëria, ku i pritej koka edhe disidencës më të pafajshme, qe një punë e mallkuar. Por ky është një kapitull i mërzitshëm, me gjëra të njohura, të zhvlerësuara pas rënies së Murit të Berlinit. Për më tepër askush nuk do të më ndiqte dot në tunelin e errët të atyre dekadave të gjata, kur gradualisht m'u degraduan dhëmbët, një pjesë më ranë para kohe, të tjerët i shkula së fundi, i zëvendësova me proteza, kështu që, edhe kur më vjen për të qarë, mund të qesh sa të dua, pa pasur frikë se do të dukem tmerrësisht i shëmtuar, siç dukeshja para se të vija protezat.

Tani, pas këtyre parantezave paradoksale, është çasti të futem në temë, të tregoj si e në ç'rrethana, ndërsa Treni çante hapësirat e Europës, unë po shkoja në takim me Al Paçinon dhe Kavabatën. Për shkak të një bllokimi të pabesueshëm të trurit, aftësia ime intelektuale që në nivelin zero; nuk isha në gjendje të bëja asgjë, as të lexoja, as të shkruaja, s'kisha kolegë. Përkundrazi, zura t'u përkushtohesha me zell veprimeve të përditshme. Isha nisur në udhëtim me dy çanta të madhësisë mesatare, të cilat në Paris u bënë tri, m'u desh të blija një të re, relativisht të madhe, për materialet e Trenit, dosja e të cilave fryhej nga qyteti në qytet dhe mua më vinte keq të çliroheshja prej tyre, dua të them t'i hidhja në kosh. Pastaj, sidoqoftë, ishin dhuratat. Më

tej këmishët dhe ndërresat e reja. Qe më me leverdi të blija këmisha e ndërresa të reja, sesa të laja të përdorurat nëpër hotele kundrejt një çmimi dukshëm më të lartë. Bërja dhe zhbërja e bagazheve, në të shumtën e rasteve me ngut çastin e fundit, kujdesi për të lidhur në dorezën e çantave kartonin me ngjyrën e caktuar të hotelit pasardhës, më përfitonin kënaqësi. Nuk më duhej ta vrisja mendjen për asgjë, për mua mendonin të tjerët, deri në hollësitë më të vogla, çdo gjë ishte e parashikuar, e planifikuar dhe më pas, në kabinë, do të mund të flija i qetë për të plotësuar sadopak mungesën e gjumit ose të soditja peizazhin e Europës e, në ndonjë rast, të zhytesha në spekulime gati filozofike.

Pikërisht në një nga këto çaste, po them të një dembelie të ëmbël, rashë në një kurth. Qe diçka e papritur e unë nuk mund t'i ruhesha. Ndërsa Treni lëkundej me zhurmën përgjumëshe, në kabinën ku po rrija u fut portugezja Igenes Pedrosa. Në dorë mbante një bllok. Me buzëqeshjen e saj engjëjlore ajo më kërkoi të shënoja në bllokun e saj epitafin që mendoja se do të mund të shkruhej mbi...

pllakën e varrit tim! Në fillim nuk e kuptova se çfarë më kërkonte dhe Ignesi, me sytë e kthjellët, të pafajshëm si sytë e një fëmije, më shpjegoi edhe një herë se kërkonte pikërisht atë, epitafin që unë mendoja se do të mund të shkruhej mbi pllakën e varrit tim... Mbeta i shushatur, qe pyetja më e papritur, s'më kishte qëlluar ndonjëherë ta vrisja mendjen për këtë gjë. Ngrita supet, i thashë Igenesit se më duhej të mendohesha e ajo qeshi, e, tek dilte nga kabina, më kërcënoi me gisht: Duhet ta gjesh patjetër epitafin tënd. Unë s'të shqitem!

Nuk më kujtohet në ç'pikë të udhëtimit ndodheshim, ka shumë të ngjarë të ndodheshim ende në Perëndim, dua të them në Europën e sotme të Bashkuar dhe Treni çante më tej, gjithmonë përmes fushash e pyjesh të pafundme drejt Europës tjetër dhe unë, i ngecur në kurthin e pyetjes së Igenesit, zura të vrisja mendjen, vërtet, cili do të qe epitafi që do të shkruhej mbi varrin tim? Ky ka qenë momenti i parë kthesë i udhëtimit, kur gjendja ime shpirtërore ndryshoi. Mbase pyetja e Igenesit nuk ka lidhje fare me këtë. Shkaku i vërtetë ndoshta ka qenë

kalimi nga një Europë në tjetrën. Unë nuk ndihesha i qetë, një lukth më zinte frymën, më bënte të kujtoja muzgun e jetës së tim ati, kur ai luante në piano fuga të Bahut, e kjo nisi në Kaliningrad, me hutimin nga tingujt e balalajkave dhe bukuria magjepsëse e vajzave ruse, nga peizazhi i hirtë me një zymtësi të rëndë i qytetit, prania impresionuese e ushtarakëve dhe ceremonia festive që më kujtonin diçka tepër të njohur, e të gjitha këto ma kthyen në obsesion dëshirën për të gjetur epitafin që do të mund të shkruhej mbi pllakën e varrit tim. Në kundërshtim me porosinë kategorike të mjekut, në kundërshtim edhe me regjimin gati prej murgut të jetës sime në Shqipëri, zura të rrisja dozat e alkoolit. Në fillim të verës së kuqe. Më pas, të vodkës. Në Shën Petërsburg bleva dy shishe treçerek-litërshe *Smirnoff*, të cilat i mbarova natën e fundit, në Berlin.

Tani mendoj, se në një pikëpamje, Treni ka qenë një eksperiment. Pjesëmarrësit u shfaqën origjinalë në mënyrat e reagimit të tyre, në kushtet e veçanta të këtij eksperimenti, ku si laborator shërbeu hapësira e Europës. Në

raştin tim, pa e kuptuar, zura të sillesha si një adoleshent i lëshuar nga zinxhirët, duke harruar se në nofullat e mia nuk kishte më dhëmbë, kishte vetëm proteza, dhe ashtu si Zorba i grekut nobelist Nikos Kazantzaki, zura të mendoj se të kafshosh, qoftë dhe me proteza, nuk është ndonjë mëkat. Kështu mbërrij në atë mbrëmjen veriore në Riga, kur në trurin tim për herë të parë Europën e përfytyrova në trajtat e një femre, më saktë të një vajze të bukur si një ëndërr, ëndërr të cilën kërkon ta shohësh prapë, por kjo është e pamundur.

Po ktheheshim në Riga me një anije turistike, pas një vizite diku, në një pikë kufitare të ish-BS, të mbushur me bunkerë. Ashtu si në vajtje dhe në kthim kisha zënë vend në pjesën e brendshme të anijes, në një karrige pranë orkestrës. Ajo ndodhej tutje, përballë meje. Ishte e pamundur të mos më binte në sy, e kisha vënë re madje edhe gjatë vizitës në plazhin muze me bunker, në shoqërinë e një gruaje dhe një vajze tjetër më të vogël. Me gotën e verës në dorë, ndërsa djemtë e orkestrës u futën në